




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE
SEKRETARIA TEKNIKE

Nr. 264/s Prot.,

Tiranë, 16.04.2025

Lënda: Përcillet Vendimi Nr. 217, datë 04.04.2025 i KKTKM-së

DREJTORISË RAJONALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, TIRANË

Adresa: Rruga "Sandër Prosi", Te mozaiku, Tiranë

Për dijeni:

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Rr. "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Ndërtesa nr. 3, Tiranë

BASHKISË MAT

Adresa: Sheshi "Ahmet Zogu" Burrel

INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Ish Kinostudio, Tiranë

Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale në mbledhjen e datës **04.04.2025**, mori **Vendimin nr. 217**, në përputhje me Ligjin Nr. 27, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", nenin 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Urdhrin Nr. 223, datë 03.07.2021 "Për miratimin e Rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të saj".

Lutemi gjeni bashkëlidhur kopje të vendimit të sipërcituar.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 240 Prot.

Tiranë, më datë 04.04.2025

VENDIM

Nr. 217, datë 04.04.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 04.04.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e rishikimit të preventivit sipas manualit të restaurimit për projektin “Restaurim i Urës së vogël te Gurra e Kodrës”, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me aplikues dhe zhvillues **DRTK Tiranë**;
 2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
 4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Joli MITROJORGJI

KRYETAR
Blendi GONXHJA

